

Kosova dhe Agjenda 2030: Nga Retorika Politike në Veprime Konkrete

Autor: **Hermonda Kalludra**
Burim Ejupi

Editor: **Dardan Abazi**

Kontribues: **Fatbardha Restelica**
Donika Beqiri

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Korrik 2019**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Rockefeller
Brothers
Fund

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

1. Hyrje	1
2. Konteksti i OZHQ-ve	3
2.1. Paraardhësit e OZHQ-ve	3
2.2. Rëndësia e Agjendës 2030 për Kosovën	5
3. Korniza Institucionale	8
4. Sfidat në Politikëbërje dhe në Mbledhjen e të Dhënave	10
4.1. Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021	10
4.2. Sfida në Mbledhjen e të Dhënave	12
5. OZHQ-të në Makro Terme	15
5.1. Dimensioni Mjedisor	16
5.2. Dimensioni Ekonomik.....	19
5.3. Të drejtat e njeriut.....	24
5.4. Edukimi.....	28
5.5. Shëndetësia.....	31
6. Përfundimi	35
7. Rekomandimet	37

1. Hyrje

Në vitin 2016, institucionet e Kosovës publikuan dokumentin politik kyç, 'Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021', që do të përcaktonte drejtimin e zhvillimit të vendit për pesë vitet e ardhshme. Në këtë strategji u neglizhua tërësisht një sektor i rëndësishëm me nevojë të madhe për ndërhyrje institucionale, shëndetësia. Ndërsa, strategjia e trajton sektorin e drejtësisë vetëm në një shkallë, pasi që tenton të ofrojë disa zgjidhje për të, por që këto zgjidhje limitohen vetëm në çështjet që lidhen me rritjen ekonomike – kur në fakt ky është sektor në të cilin korrupsioni po vazhdon të lulëzojë dhe minojë procesin e zhvillimit të përgjithshëm të vendit. Edhe pse strategjia përmban elemente për zhvillim, në të mungon një përpunim i agjendës kryesore të zhvillimit që vendi ka premtuar të zbatojë, specifikisht Agjendën e vitit 2030. Përkundër disa përpjekjeve për të çelur temën e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), institucionet e Kosovës kanë vazhduar të injorojnë rëndësinë e Agjendës 2030. Në kontrast me vendet e tjera që tashmë kanë krijuar strategji për nacionalizimin e Agjendës 2030 dhe raporte vlerësimi të publikuara rreth zbatimit të OZHQ-ve, Kosova sot nuk ka kornizë të qartë zhvillimi për Agjendën 2030, linjë të qartë buxhetore për zbatimin e saj dhe ka përcaktuar strategji të zhvillimit që mezi përputhen me 17 objektivat e agjendës.

Nëse konsiderohet gjendja e Kosovës në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm, kjo ndihmon për të vizualizuar rrugën dhe vizionin që vendi duhet të ndjekë. Prandaj, në thelb të këtij raporti qëndron vlerësimi i përpjekjeve të deritanishme të Kosovës në përmbushjen e Agjendës 2030, si dhe paraqitja e politikave dhe sfidave në mbledhjen e të dhënave. Vendi nuk është anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), e as i Bashkimit Evropian (BE), por arritja e Agjendës 2030 padyshim e ndihmon Kosovën drejt integritimit në të dyja sistemet. Vende të shumta kanë integruar OZHQ-të në strategjitë e tyre drejt pranimit në BE-së. Shembull, Shqipëria ka përfshirë Agjendën 2030 në Strategjinë e Integritimit Evropian dhe ka publikuar vlerësimin e saj të parë të strategjisë kombëtare prej perspektivës së OZHQ-ve. Kosova posedon kapacitete për të ndjekur këtë shembull, pasi i ka të gjithë mekanizmat e nevojshëm për ta bërë këtë, si: organizatat ndërkombëtare që merren me politika zhvillimore, shoqërinë civile aktive dhe institucionet funksionale.

Ky raport përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë paraqet një prezantim të shkurtër të asaj se si ka ardhur deri te Agjenda 2030, shpjegon ndikimin e institucioneve që kanë rol kryesor për zhvillim, si dhe bën lidhjen e tyre me OZHQ-të. Në këtë pjesë trajtohen, gjithashtu, edhe analizat e përpjekjeve të hartimit të politikave të Kosovës në arritjen e Agjendës 2030. Kjo pjesë thekson se Agjenda 2030 ka rëndësi të madhe për rrugën e zhvillimit të Kosovës dhe procesin e saj të integritimit në arenën ndërkombëtare. Pjesa e dytë vlerëson progresin që vendi ka bërë drejt arritjes së OZHQ-ve. Kjo pjesë paraqet një pasqyrë statistikore të trendeve më të fundit të treguesve të OZHQ-ve në Kosovë, në të cilat, vite specifike varen nga disponueshmëria e të dhënave për treguesit individualë. Të gjitha 16 OZHQ-të janë grupuar në pesë shtylla - 1) mjedisi, 2) ekonomia, 3) të drejtat e njeriut, 4) arsimit dhe 5) shëndetësia.

Sfidat e grumbullimit të të dhënave, gjetja e informacionit të besueshëm dhe të qëndrueshëm në lidhje me treguesit e OZHQ-ve, janë shënuar si pengesa në matjen e progresit të vendit drejt arritjes së Agjendës 2030. Prandaj, ky dokument inkurajon institucionet relevante të sigurojnë të dhëna dhe të përmirësojnë kapacitetet për përpilimin e të dhënave të detajuara dhe të besueshme. Për këtë arsye, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), ka vendosur të merret me vlerësimin e përpjekjeve të vendit drejt Agjendës 2030 dhe të hartojë një raport që cakton se ku mbeten pengesa në përcaktimin e rrugës së zhvillimit për vendin. Kjo, me qëllim që të mundësohet zbatimi real i OZHQ-ve dhe të stimulohen institucionet zyrtare në vendosjen e kornizës së qartë për spektrin e zhvillimit, në kontekstin kosovar.

2. Konteksti i OZHQ-ve

2.1. Paraardhësit e OZHQ-ve

Deri tash, OKB-ja i ka udhëhequr përpjekjet për avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm përmes konferencave të nivelit të lartë. Në vitin 1992, është mbajtur Samiti i Tokës në Rio de Janeiro - një konferencë e rëndësishme globale lidhur me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm¹. Tutje, në vitin 2000, një përpjekje tjetër globale u fillua në trajtimin e indinjtës së varfërisë - 189 vende nënshkruan Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM). Për 15 vite, mes prioriteteve të shumta për zhvillim, iniciativa nxiti përparimin në vendosjen e objektivave të matshme dhe të pranuar në mënyrë universale për arsim, shëndetësi, varfëri dhe uri². Efekti dhe arritjet e OZHM-ve hapën rrugën që në vitin 2015, OKB të integrojë edhe më thellë zhvillimin e qëndrueshëm në të gjitha nivelet e hartimit të politikave të vendeve, duke zëvendësuar kështu OZHM-të me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) - qëllimet e reja – dhe duke miratuar Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

OKB ka deklaruar se Agjenda e vitit 2030 është "... e fushëveprimit dhe rëndësisë së paprecedentë. Ajo është pranuar nga të gjitha vendet dhe është e zbatueshme për të gjithë, duke marrë parasysh realitetet e ndryshme kombëtare, kapacitetet dhe nivelet e zhvillimit dhe duke respektuar politikat dhe prioritetet kombëtare. Këto janë qëllime dhe objektiva universale që përfshijnë gjithë botën, si vendet e zhvilluara, njashtu edhe ato në zhvillim..."³. Kjo agjendë ka bazë 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm, 169 qëllime të ndërlidhura dhe 230 indikatorë - secila prej objektivave ka numrin e caktuar të qëllimeve dhe treguesve që ndihmojnë për të matur nivelin e progresit drejt objektivave. Iniciativa përcakton objektivat e mëposhtme:

1. Zhdukja e varfërisë kudo dhe në të gjitha format,
2. Zhdukja e urisë, arritja e sigurisë në ushqyerje, përmirësimi i të ushqyerit dhe promovimi i bujqësinë së qëndrueshme,
3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjitha moshat,
4. Sigurimi i arsimit cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënit gjatë gjithë jetës,
5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave,

¹ Konferenca e OKB-së për Mjedisin dhe Zhvillimin (1992). Lidhja e qasshme në:

<https://www.un.org/geninfo/bp/enviro.html>

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Historiku i objektivave. E qasshme në: <https://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals/background.html>

³ Rezoluta e OKB-së A / RES / 70/1 - Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. E qasshme në: <https://sustainabledevelopment.un.org/index.php?page=view&type=111&nr=8496&menu=35>

6. Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve,
7. Sigurimi i qasjes në energji të përbalueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe modern,
8. Nxitja e rritjes ekonomike së qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimi i plotë dhe produktiv, dhe punë e denjë,
9. Ndërtimi i infrastrukturës së qëndrueshme, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit,
10. Ulja e pabarazisë përbrenda dhe midis vendeve,
11. Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta dhe të qëndrueshme,
12. Sigurimi i konsumit të qëndrueshëm dhe modeleve të prodhimit,
13. Ndërmarrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj,
14. Konservimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve ujore për zhvillim të qëndrueshëm,
15. Mbrojtja, rivendosja dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, luftimi i shkretimit, ndalimi dhe ndryshimi i degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit,
16. Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet,
17. Forcimi i mjeteve të zbatimit për/dhe rigjallërim i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm.

Përderisa OZHM-të janë paraardhës të OZHQ-ve, Grupi i Bankës Botërore (GBB) dhe Raportet e Zhvillimit Njerëzor (RZHN) mbesin të lidhura ngushtë me OZHQ-të. Pararendës të tillë formojnë paketën OZHQ, në të cilën të gjithë këta komponentë veprojnë për të përmbushur të njejtën agjendë.

GBB mban rolin pioner, duke udhëhequr OKB-në në arritjen e OZHQ-ve, meqë objektivat e OZHQ-së janë në përputhje edhe me objektivat e GBB-së. GBB gjithashtu punon me vendet e saj anëtare për përafrimin me Agjendën 2030 përmes tri fushave kryesore: 1) financimit, 2) të dhënave, dhe 3) implementimin – duke iu ndihmuar shteteve për të arritur OZHQ-të⁴. Objektivat e Bankës janë në harmoni me OZHQ-të, sidomos objektivat lidhur me varfërinë dhe pabarazinë. Shumë nga OZHQ-të e tjera janë të lidhura drejtpërdrejt me punën e Bankës, si shëndeti (OZHQ 3), arsimi (OZHQ 4),

⁴ Banka Botërore. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) dhe Agjenda 2030. E qasshme në: <http://www.worldbank.org/en/programs/sdgs-2030-agenda>

uji (OZHQ 6), energjia (OZHQ 7) dhe ndryshimet klimatike (OZHQ 13)⁵. Banka Botërore është gjithashtu e angazhuar zyrtarisht me monitorimin dhe zhvillimin e rreth 42 treguesve. Rrjedhimisht, roli i Bankës mbetet kritik në arenën e zhvillimit, pasi që ajo tenton të lehtësojë zbatimin e OZHQ-ve duke ofruar mundësi financimi, skema të reduktimit të varfërisë dhe duke nxitur zhvillimin afatgjatë ekonomik dhe social, kryesisht në botën në zhvillim.

Edhe pse Banka Botërore është institucion ndërqeveritar i përqendruar kryesisht në aspektin ekonomik të aspekteve të lartpërmendura, në vitin 1990, Raporti i parë i Zhvillimit Njerëzor prezantoi një qasje të re për avancimin e mirëqenies njerëzore, që është i përqendruar kryesisht në begatinë e jetës njerëzore - aspekte këto të lidhura në mënyrë të rëndësishme me Agjendën e vitit 2030. Ndërkohë që vendet në bashkësinë ndërkombëtare shkojnë drejt përmbushjes së OZHQ-ve, qasja e zhvillimit njerëzor vazhdon të shërbejë si qasje lehtësuese "për artikulimin e qëllimeve dhe për përmirësimin e mirëqenies së njerëzve, duke siguruar një planet të barabartë, të qëndrueshëm dhe stabil"⁶. Banka Botërore dhe Raportet e Zhvillimit Njerëzor luajnë rol thelbësor në eksplorimin e temave të ndryshme përmes zhvillimit dhe kanë pasur ndikim të gjerë në debatin e zhvillimeve rajonale dhe globale. Ndërlidhja e tyre me OZHQ-të ka mundësuar që këto organe të raportojnë dhe mbikëqyrin arritjen e Agjendës 2030 dhe gjithashtu në mënyrë konstruktive të sfidojnë politikatat relevante.

Në anën tjetër, BE ka rol kyç në zhvillimin e qëndrueshëm për anëtarët e saj dhe për vendet anëtare aspiruese. BE-ja ka prezantuar strategji të integruara politike që merren me zhvillimin e qëndrueshëm në mënyrë që të krijohen rregullativa dhe parime udhëzuese më të mira. Një strategji e veçantë e tillë është Strategjia për Zhvillim të Qëndrueshëm e BE-së që synon të bëjë "një përdorim efikas të burimeve të cilat janë në gjendje të kapërcejnë potencialin ekologjik dhe social të ekonomisë dhe që në fund janë të afta për të siguruar mbrojtjen e mjedisit, prosperitetin dhe kohezionin social"⁷. Përderisa aspiratat e Kosovës mbeten të fokusuara në anëtarësimin në BE, Strategjia për Zhvillim të Qëndrueshëm e BE-së, edhe pse nuk ka karakter legjislativ, duhet të merret seriozisht në konsideratë gjatë bërjes së politikave kryesore për zhvillim, duke siguruar që këto politika të jenë plotësisht në përputhje me parimet e BE-së për zhvillim.

2.2. Rëndësia e Agjendës 2030 për Kosovën

Edhe pse miratimi i Agjendës 2030 bëhet në baza vullnetare, shumë vende tashmë e konsiderojnë kornizën e Zhvillimit të Qëndrueshëm një vizion se si vendi i tyre duhet të jetë në vitin 2030. Kosova rastisë të ndjekë plan të zhvillimit bazuar në të njëjtën ide dhe ilustruesi më i mirë i kësaj është aprovimi i Kuvendit në miratimin e rezolutës për ndërmarrjen e hapave drejt arritjes së Agjendës 2030⁸. Rezoluta

⁵ Bloget e Grupit të Bankës Botërore. Roli i Bankës Botërore në monitorimin e OZHQ-ve. E qasshme në: <https://blogs.worldbank.org/opendata/world-bank-s-role-sdg-monitoring>

⁶ Raporti i UNDP i Zhvillimit Njerëzor, i qasshëm në: <http://hdr.undp.org/en/humandev>

⁷ Komisioni European. Strategjia BE-së për Zhvillim të Qëndrueshëm. E qasshme në: http://ec.europa.eu/environment/sustainable-development/strategy/index_en.htm

⁸ Progresi i Kosovës për OZHQ-të në vitin 2018. E qasshme në: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,1139>

u miratura me qëllim krijimin e partneritetit me akterë të ndryshëm për zbatimin e agjendës dhe funksionalizimin e Këshillit për monitorimin dhe sigurimin e zbatimit të OZHQ-ve. Të dy rezultatet përfundimtare të rezolutës janë lënë vetëm në diskursin retorik. Partneriteti ka qenë i palëvizshëm, pa bërë asnjë përpjekje të dukshme në përmbushjen e Agjendës 2030. Këshilli mbi OZHQ-të mbeti joaktiv, edhe pas një viti të themelimit, pa raporte vlerësimi dhe pa kornizë të zhvillimit të qëndrueshëm deri tani.

Kosova, si një vend me miliona fonde të futura për krijimin e një shtetësie moderne, me zhvillim të qëndrueshëm, nuk është më një koncept embrional. Në këtë kontekst, Agjenda 2030 ka rol të rëndësishëm për të ardhmen e vendit. Për Kosovën, si një vend unik nga vendet e tjera, Agjenda synon të hedh dritë mbi aftësinë e vendit për të vepruar si entitet në gjendje për të shtetëzuar iniciativat globale, për të kontribuar në çështjet globale dhe për të demonstruar prirje për t'u integruar në arenën ndërkombëtare.

Agjenda e vitit 2030 tenton ta përgatisë vendin drejt integritit në BE. Kjo, duke pasur parasysh se shtetëzimi i OZHQ-ve dhe procesi i pranimit në BE mbeten të lidhura ngushtë si komplementaritet midis dy agjendave ekzistuese të pranimit. Megjithëse agjenda e integritit në BE dhe Agjenda 2030 ndryshojnë në shumë aspekte, të tilla si dimensionimi i fushëveprimit (agjenda e BE-së është më e ngushtë), qëllimet e tyre përfundimtare (njëra është arritja e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, tjetra anëtarësimi), përfundimisht të dyjat merren me një numër çështjesh të ngjashme që shtyjnë vendet drejt përparimit. Duke pasur në mendje këtë lidhje, Shqipëria veçse ka integruar Agjendën 2030 në procesin e saj të integritit evropian⁹. Kur është fjala për Kosovën, ajo në dokumentin e saj zhvillimor, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, vetëm pohon se "... është në një fazë të rëndësishme të agjendës së saj të zhvillimit drejt integritit evropian në të gjitha fushat" - por nuk elaboron më tutje se si Agjenda 2030 shërben si nxitëse në reforma, apo cilat politika do të ndërmerren për të lehtësuar zbatimin e OZHQ-ve të përforcuara reciprokisht edhe me kërkesat e BE-së.

Që nga shtatori i vitit 2015, kur u bë miratimi i Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe 17 OZHQ-ve të saj, BE-ja ka pasur rol vendimtar në këtë proces. Këshilli Evropian ka konfirmuar se BE dhe shtetet e saj anëtare do të kenë rol kryesues në zbatimin e OZHQ-ve, specifikisht thotë se: "BE-ja dhe shtetet anëtare janë fuqimisht të përkushtuara për zbatimin e Agjendës 2030 në mënyrë të plotë, koherente, të integruar dhe efektive, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët dhe akterët e tjerë, përfshirë autoritetet nën-kombëtare, shoqërinë civile, sektorin privat, partnerët socialë dhe akademinë"¹⁰. Megjithëse, kjo nuk i drejtohet shteteve joanëtare të BE-së, një nga agjencitë më të rëndësishme të Komisionit Evropian, Eurostat-i, tashmë po lëshon raporte të veçanta për shtatë

⁹ Republika e Shqipërisë, 2018. Shqyrtimi Vullnetar Kombëtar mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. E qasshme në:

https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA_VNR_2018_FINAL2.pdf

¹⁰ Këshilli i Bashkimit Evropian, 2017. Rezultati i mbledhjes së Këshillit E qasshme në:

<http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10370-2017-INIT/en/pdf>

kandidatët dhe anëtarët potencial të BE-së¹¹, për përparimin e tyre kryesisht në pesë OZHQ (përfshirë Kosovën). Kjo tregon se zbatimi i OZHQ-ve brenda vendeve aspiruese është marrë seriozisht nga institucionet e BE-së. Prandaj, progresi në zbatimin e këtyre masave do të jetë me rëndësi të madhe për procesin e integritimit. Lidhur me këtë, për Kosovën, që momentalisht mban statusin e kandidatit potencial, bërja e përpjekjeve në shtetëzimin e kornizës së Agjendës 2030 dhe krijimi i instrumenteve kryesore që kontribuojnë në arritjen e OZHQ-ve, do të shërbente si hap pozitiv në caktimin e trendeve progresive të saj drejt integritimit në BE.

Vetë Qeveria ka pranuar se marrëveshja e parë kontraktuale e nënshkruar midis Kosovës dhe Bashkimit Evropian, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit 2016, që ka qëllim zbatimin e qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe zhvillimin ekonomik, duhet të analizohet veçanërisht nga perspektiva e OZHQ-ve¹². Rrjedhimisht, si pasojë e rritjes së rëndësisë së Agjendës 2030 për anëtarët aspirues të BE-së dhe për Kosovën, shtetëzimi i OZHQ-ve dhe integrimi, mbeten të rëndësishme për të ardhmen e vendit në BE dhe janë përparësi kryesore e zhvillimit të vendit. Njëkohësisht, duhet të fillojnë iniciativat në lidhje me zbatimin e Agjendës 2030 për të hyrë në praktikë dhe për të gjeneruar efektet e tyre. Përndryshe, nëse ato vazhdojnë të përdoren vetëm në diskursin politik, vendi rrezikon të dëmtojë rëndësinë e Agjendës, e që pasohet me ndikim negativ në të ardhmen e saj evropiane.

¹¹ Aktualisht, Mali i Zi, Maqedonia Veriore, Shqipëria, Serbia dhe Turqia kanë statusin e kandidatit, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova mbajnë statusin e kandidatëve potencialë. Shih Eurostat, 2019. Vendet e Zgjerimit - Treguesit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. E qasshme në :https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_-_indicators_for_Sustainable_Development_Goals#General_overview

¹² Kuvendi i Republikës së Kosovës. Progresi i Kosovës për OZHQ-të në vitin 2018. E qasshme në: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,1139>

3. Korniza Institucionale


Grupet tematike të zhvillimit të qëndrueshëm janë të rrënjosura thellë në kornizën legjislativë, të tilla si: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit¹³ ose Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural¹⁴. Megjithatë, vërehet një mungesë e qartë e institucioneve në vend për t'i zbatuar ato. Deri më tani, Kosova ka dështuar kryesisht në institucionalizimin e Agjendës 2030 dhe në integrimin e treguesve kritikë të agjendës në dokumentet kryesore hartuese të politikave.

Ekziston një nevojë e veçantë për integrimin e qëllimeve globale në nivelin e brendshëm, ashtu që të përshpejtohet veprimi mbi objektivat dhe të krijohet një vizion i përbashkët për rrugën përpara. Një numër i madh i vendeve kanë institucionalizuar zbatimin e veprimeve lidhur me OZHQ-të. Për shembull, Holanda ka caktuar Ministrinë e Punëve të Jashtme si udhëheqëse për konsultim me institucionet e tjera, ndërsa ka ngritur edhe pika qendrore të OZHQ-ve në të gjitha ministrinë¹⁵. Vendet fqinje si, Shqipëria dhe Mali i Zi, kanë ndjekur të njëjtin shembull¹⁶. Ndërsa në Kosovë, jo vetëm që Këshilli i premtuar për zbatimin e OZHQ-ve vazhdon të mbetet kryesisht joaktiv, vendi ka dështuar edhe të integrojë OZHQ-të në dokumentet e politikave dhe veprime konkrete atëherë kur ekzistonte mundësia për ta bërë këtë.

Ministria e Shëndetësisë

Strategjitë e shqyrtuara:

1) Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017 - 2021



¹³ Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03 / L-025. E qasshme në: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-025_en.pdf

¹⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Ligji Nr. 03 / L-098. E qasshme në: https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-98_al.pdf

¹⁵ Statistikat, Holandë, 2018. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: situata për Holandën. E qasshme në: <https://static1.squarespace.com/static/59f7031e8dd0415634a7fc46/t/5b9b8d8388251b4c42ff386f/1536920971476/th-e-sustainable-development-goals.pdf>


¹⁶ Këshilli i Ministrave, Republika e Shqipërisë dhe Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, 2018. Shqipëria, Raporti mbi Harmonizimin e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm me Politikat Sektoriale Ekzistuese. E qasshme në: <https://www.un.org.al/sites/default/files/Albania%20Report%20on%20the%20Harmonization.pdf>

Para se të kalojmë në kapitullin e ardhshëm, që trajton konkretisht dhe në thellësi dokumentin bazë të vendit për zhvillim, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka shqyrtuar 4 strategjitë e dy organeve qendrore, Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), në mënyrë që të kuptohet nëse qëllimet e OZHQ-ve pasqyrohen në këto dokumente. INDEP-i ka zgjedhur këto dy institucione për shkak të kapaciteteve të kufizuara të brendshëm të tyre, si dhe punën e ngushtë që ka bërë me grupin punues për reformën e pensioneve. Aktualisht, INDEP është në proces të publikimit të dy punimeve mbi reformat e pensioneve dhe çështjet e sigurimeve shëndetësore në Kosovë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Strategjitë e shqyrtuara:

- 1) Plani i Veprimit për Rritjen e Punësimit të të Rinjve 2018-2020,
- 2) Strategjia Sektoriale e MPMS-së 2018-2022,
- 3) Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021.



Grafikat tregojnë shtrirjen e OZHQ-ve në strategjitë e krijuara nga institucionet e lartpërmendura në nivel qendror. Rrjedhur nga analiza krahasuese ndërmjet objektivit të OZHQ-ve dhe qëllimit të strategjisë, ne pamë nëse objektivi i OZHQ ishte pasqyruar ose jo në dokument. Nëse qëllimi u pasqyrua, vazhduam me analizimin se në çfarë shkalle ishte ajo shtrirje - plotësisht, pjesërisht apo aspak në përputhje¹⁷. Siç mund të shihet në grafikët e paraqitur më lartë, pothuajse më shumë se 35% e të gjitha dokumenteve treguan të jenë të papërputhura me objektivat e OZHQ-ve dhe me një përqindje shumë të ulët të përputhjes.

¹⁷ Termet e aplikuara janë referuar si më poshtë: Plotësisht në përputhje - Ekziston një objektiv në strategjinë e planifikimit që është në përputhje me një objektiv të OZHQ-ve; Pjesërisht në përputhje - Ekziston një objektiv në strategjinë e planifikimit që është në përputhje me një objektiv të OZHQ-ve, por jo plotësisht ose jo në fushën e tij apo në qëllimin; Aspak në përputhje - Nuk ekziston asnjë objektiv në strategjinë e planifikimit që është në përputhje me ndonjë objektiv të OZHQ-ve

4. Sfidat në Politikëbërje dhe në Mbledhjen e të Dhënave

4.1. Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021

Zhvillimi ka qenë pjesë jetike e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës (2016-2022). Strategjia ka krijuar një plan zhvillimi të përqendruar në "qasjen e re në politikën e zhvillimit" që njih nevojën për adresimin e të gjithë faktorëve që aktualisht kufizojnë rritjen ekonomike dhe përmirësimin e standardit të jetesës, duke aplikuar në këtë mënyrë një qasje që 'trajton zhvillimin si një shumëllojshmëri ndërmarrje'¹⁸. Krahasuar me strategjitë e tjera kombëtare, Strategjia 2016-2021 përmban cilësi të përmirësuar dhe synon të adresojë shtyllat që lidhen kryesisht me aspektin ekonomik¹⁹. Strategjia, proporcionalisht, zgjedh prioritetet dhe masat që duhen ndërmarrë për të eliminuar pengesat dhe për të mundësuar zhvillimin ekonomik. SKZH identifikon katër shtylla si zonat ku nevojitet më shumë ndërhyrje: 1) kapitalin njerëzor, me fokus në gjenerimin e punës dhe aftësive teknike; 2) qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, për të hequr veçanërisht pengesat e mbetura në ekonominë e tregut; 3) industrinë konkurruese; dhe 4) infrastrukturën, e fokusuar kryesisht në energji.

Strategjia ofron veprime konkrete për zbatimin e çdo shtylle, të lidhura me fushat e tjera të planifikimit strategjik, priorizimin e ndihmës financiare, ndërtimin e kapaciteteve, monitorimin e progresit, si dhe krijimin e një fondi për zhvillim dhe punësim. Megjithatë, strategjia mbetet e kufizuar kur vjen puna te prioritet e saj. Në mënyrë që një vend të arrijë zhvillim të qëndrueshëm, një numër i madh i çështjeve të ndërlidhura njëra me tjetrën duhet të preken. Në përgjithësi, ajo që strategjia bën është lidhja e të katër shtyllave drejt arritjes së një qëllimi mbizotërues, atij të punësimit. Nga njëra anë, fokusi i saj në kapitalin njerëzor, qeverisjen e mirë dhe ndërmarrjet, bazuar në arsyen se forca e re e punës në Kosovë siguron punë të lirë, plotësisht neglizhon potencialin e zhvillimit njerëzor dhe lidhjen e tij me zhvillimin e përgjithshëm të qëndrueshëm. Ndërsa, nga ana tjetër, strategjia si dokument politik kyç është zhvilluar rreth qëllimit të qeverisë për të justifikuar ndërtimin e një termocentrali me qymyr²⁰ - një veprim që tenton të rrezikojë procesin e qëndrueshmërisë mjedisore, i cili ka qenë gjithashtu një proces shumë i kontestuar nga ana e organizatave dhe shoqërisë civile në Kosovë.

Katër fusha të politikave në të cilat është përqendruar Strategjia, trajtohen në mënyrë të pavarur në hapësirën e tyre, por kjo bëhet pa shpjeguar tiparet e tyre të përbashkëta me objektivat e OZHQ-ve. Vlerësimi i INDEP-it për strategjinë tregon se këto fusha qëndrojnë të lidhura në disa mënyre direkt ose indirekt me 11 OZHQ, nga 16 objektiva të zbatueshme gjithsej, sa janë për Kosovën. Me gjithë këtë, prapëseprapë një numër jashtëzakonisht i vogël i qëllimeve të 11 OZHQ-ve mbulohen nga fushat e politikave të strategjisë. Edhe pse disa nga fushat e politikave ishin specifike për vendin, vlerësimi

¹⁸ Qeveria e Republikës së Kosovës, 2016. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH). E qasshme në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf

¹⁹ INDEP, 2018. Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë. E qasshme në: <https://indep.info/wp-content/uploads/2019/07/Sustainable-Development-Indicators.pdf?fbclid=IwAR2F0WliveRwcU4FjRQIX925yO7bj7cZ7EYdBa1AbbYBhJKgijcpuWR3SBk>

²⁰ Ibid.

tregon se mesatarisht çdo zonë mbulon rreth 3 qëllime nga numri i përgjithshëm i objektivave të çdo OZHQ-je. Më poshtë është paraqitja e qartë (Tabela 1) e numrit të drejtpërdrejtë të objektivave dhe qëllimeve të lidhura me secilën fushë të politikave të SKZH.

Tabela 1: Shtirirja e shtyllave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM (2016-2021)	OZHQ-TË E PËRPU THURA ME SKZH	NUMRI I QËLLIMEVE TE LIDHURA ME FUSHAT ME FUSHAT E POLITIKAVE
1. KAPITALI NJERËZOR	OZHQ4 (10 Qëllime)	6
	OZHQ8 (12 Qëllime)	2
2. QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT	OZHQ10 (10 Qëllime)	1
	OZHQ12 (14 Qëllime)	1
3. INDUSTRI TË KONKURRUESE	OZHQ2 (8 Qëllime)	1
	OZHQ7 (5 Qëllime)	1
	OZHQ9 (8 Qëllime)	1
	OZHQ10 (10 Qëllime)	1
4. INFRASTRUKTURA	OZHQ4 (10 Qëllime)	4
	OZHQ5 (9 Qëllime)	1
	OZHQ6 (8 Qëllime)	1
	OZHQ7 (5 Qëllime)	1
	OZHQ9 (8 Qëllime)	3
	OZHQ11 (10 Qëllime)	2
	OZHQ15 (12 Qëllime)	1

Pos numrit të pamjaftueshëm të objektivave të integruara në strategji, Tabela 1 dëshmon se një dokument i tillë i rëndësishëm politik duket se nuk ka një aplikim të një qasjeje të bazuar në tregues (indikatorë) kur merret me sfida. Për shkak të numrit të kufizuar të objektivave të trajtuara, automatikisht arrihet në përfundimin se nga të gjithë treguesit që një objektiv mund të ketë, strategjia i ka të përfshirë vetëm disa prej tyre.

Shkalla e shpërputhjes ndërmjet OZHQ-ve dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (2016-2021), lë vendin prapa në realizimin e objektivave dhe përcaktimin e prioriteteve në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm. Si pasojë, në të ardhmen kur vjen koha për të raportuar OKB-në ose BE-në mbi zbatimin e OZHQ-ve, Kosova do të jetë edhe prapa vendeve të tjera në rajon që kanë futur tashmë Agjendën 2030 në politikat e tyre të brendshme. Është me rëndësi të theksohet fakti se integrimi i OZHQ-ve në Strategjinë Kombëtare gjithashtu e ndihmon vendin në orientimin e donatorëve ndërkombëtarë drejt zonave që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente - fusha të cilat pengojnë vendin nga aftësia për përcaktimin e së ardhmes së saj për zhvillim. Për shembull, sektori i shëndetësisë dhe i drejtësisë konsiderohet si shumë i nevojshëm për ndërhyrje institucionale (siç do të tregojnë analizat në seksionin e dytë) dhe kërkojnë një strategji të orientuar drejt zhvillimit. Sidoqoftë, strategjisë i mungojnë të dy sektorët kritikë për zhvillim.

Strategjia, pos mungesës së këtyre dy sektorëve, nuk ka as shpjegim mbi trendet që ndjek çdo fushë e politikave. Për shembull, ajo paraqet shkurtimisht arsyet pse kjo fushë politike është konsideruar si problematike, cilat janë sfidat dhe zgjidhjet, pasuar nga një paragraf përmblyës me ndikim në zhvillimin ekonomik. Kjo, pa treguar nëse vitet e fundit kanë pasur progres apo jo, nëse po, cilat politika janë ndërmarrë që kanë ndihmuar përparimin. Nëse do të ishte shfaqur regres, atëherë mbështetja me të dhëna të sakta vetëm do t'a rrisë besueshmërinë e strategjisë.

Strategjia 2016-2021 ofron informata thelbësore të hollësishme për të gjitha fushat e politikave në lidhje me zhvillimin ekonomik në vend. Sidoqoftë, në përgjithësi ka të bëjë kryesisht me udhëzime të parëndësishme për të demonstruar rrugën që Kosova duhet të ndjekë në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, ndoshta sektori ku humbet besueshmërinë dhe rëndësinë e saj është specifikisht sektori i shëndetësisë dhe drejtësisë, pasi që të dy këta sektorë janë lënë plotësisht jashtë.

4.2. Sfida në Mbledhjen e të Dhënave

Gatishmëria dhe përkushtimi substancial i institucioneve të Kosovës në ndërmarrjen e veprimeve të sigurta të politikave që kontribuojnë në arritjen e OZHQ-ve dhe sigurimin e të dhënave të besueshme në mbikëqyrjen e progresit të vendit duhet të jenë në qendër të hartimit të një vizioni kombëtar për vitin 2030. Identifikimi i boshllëqeve të politikave dhe përshpejtimi i ndërhyrjes në fushat e politikave mbeten ende një proces sfidues, sidomos në rastet kur mungojnë të dhënat. Megjithatë institucionet e Kosovës, duke përfshirë Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), prodhojnë seri të të dhënave që në një farë mase mund të shërbejnë si bazë për monitorimin e progresit në një numër të kufizuar sektorësh, disponueshmëria dhe mbledhja e të dhënave vazhdojnë të mbeten shumë sfiduese. Në

procesin e mbledhjes së të dhënave, janë identifikuar tre sfida kryesore si pengesa që pamundësojnë vlerësimin e përpjekjeve të vendit drejt zbatimit të OZHQ-ve. Bazuar në pikat vijuese, INDEP ka përpiluar një tabelë që paraqet disponueshmërinë e të dhënave për treguesit në Kosovë nga korniza e treguesve globalë (Tabela 2).

1. Mungesa e llogaridhënies kur është fjala për ofrimin e të dhënave

As ASK, as ministrinë dhe institucionet tjera zyrtare në Kosovë nuk nxjerrin të dhëna në lidhje me funksionet e tyre përkatëse. Ekzistojnë statistika jo të plota, të pamjaftueshme për të vlerësuar punën e institucionit drejt arritjes së objektivave të OZHQ-ve dhe edhe kur të dhënat ekzistojnë, qasja në këto të dhëna është e vështirë pasi ato mbeten të mbyllura për qasjen e publikut në to.

2. Të dhënat e paqëndrueshme mes dhe brenda institucioneve

Institucionet kanë tendencë të japin të dhëna që nuk korrespondojnë me të dhënat e tjera të ofruara nga organe tjera shtetërore. Përveç kësaj, konfuziteti i të dhënave dhe mospërputhjet duket të jenë të pranishme edhe brenda një institucioni të vetëm, fakt ky që dëmton besueshmërinë e të dhënave. Për shembull, ASK është e prirur të vendosë numra të ndryshëm në uebfaqe dhe numra të ndryshëm në publikimet e saj²¹.

3. Të dhënat nuk kanë lidhje me objektivat e OZHQ-ve

ASK-ja dhe institucionet e tjera zyrtare, siç është Banka Qendrore e Kosovës, nuk kanë të dhëna të mjaftueshme që lidhen plotësisht me qëllimet e OZHQ-ve. Për shembull, të dhënat për Treguesin 11.6.1 specifikojnë se të dhënat duhet të grumbullohen për mbetjet e ngurta që kanë trajtim adekuat nga qytetet, ndërsa në Kosovë ka të dhëna të disponueshme vetëm për mbeturinat që grumbullohen nga Kompanitë Rajonale të Menaxhimit të Mbeturinave. Një numër raportesh, p.sh. një studim i Bankës Botërore 2015 paralajmëron se trajtimi i deritanishëm i mbeturinave mund të jetë i rrezikshëm për gjeneratat e ardhshme. Ky tregues lidhet vetëm me zonat urbane pasi ato prodhojnë shumicën e mbetjeve. Në këtë rast, kompanive rajonale duhet t'u jepen rekomandime për të mbledhur të dhëna për zonat urbane dhe rurale veçmas.

²¹ Shih, për shembull në faqen 118 të <http://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf> të dhënat për të njëjtat variabla (telefoni fiks dhe telefoni celular) ndryshojnë nga të dhënat në faqen e saj të internetit. E qasshme në: http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata_14%20Census%20population_Census%202011_3%20By%20Municipalities/tab%205%2025.px/table/tableViewLayout1/?rxid=eb6c9da8-94d5-4df1-a7a3-5e9722e02df7

Tabela 2: Disponueshmëria e treguesve globalë në Kosovë ²²

	<i>Numri total i treguesve</i>	<i>Lehtë të disponueshëm</i>	<i>Të disponueshëm me përpjekje</i>	<i>Pjesërisht të disponueshëm</i>	<i>Jo të disponueshëm</i>	<i>Nuk aplikohen</i>
OZHQ1	14	3	0	2	9	0
OZHQ2	13	0	0	0	13	0
OZHQ3	26	7	0	1	18	0
OZHQ4	11	1	0	0	10	0
OZHQ5	14	2	0	0	12	0
OZHQ6	11	1	0	1	9	0
OZHQ7	6	3	0	0	3	0
OZHQ8	17	2	2	0	13	0
OZHQ9	12	4	0	0	8	0
OZHQ10	11	2	1	0	8	0
OZHQ11	15	1	0	0	14	0
OZHQ12	12	0	0	0	12	0
OZHQ13	8	0	0	0	8	0
OZHQ14	10	0	0	0	0	10
OZHQ15	14	0	1	1	12	0
OZHQ16	23	4	0	0	19	0
OZHQ17	25	3	1	1	19	1

²² Lehtë të disponueshëm i referohet të dhënave për treguesit që janë të plotë, plotësisht në dispozicion dhe të ofruar nga institucionet shtetërore zyrtare dhe burime të besueshme. Të disponueshëm me përpjekje do të thotë që të dhënat janë mbledhur nga burime të shumta të besueshme për të paraqitur të dhëna të plota. Kjo gjithashtu përfshin të dhëna që duhet të llogariten në mënyrë manuale, si për shembull të dhënat për investimet në arsim. Pjesërisht të disponueshëm i referohet të dhënave që nuk janë të plota. Jo të disponueshme i referohet të dhënave që mungojnë dhe nuk ofrohen nga ndonjë burim i besueshëm. Nuk aplikohen i referohet që treguesi nuk është i zbatueshëm për kontekstin e vendit.

5. OZHQ-të në Makro Terme

Si tërësi, Agjenda 2030, konsiderohet të jetë përpjekja më ambicioze në spektrin e zhvillimit²³. Kjo është e vërtetë edhe për rastin e Kosovës, sepse vendi ka arritur të integrojë zhvillimin e qëndrueshëm në legjislaturën dhe kornizën institucionale. Një përpjekje e tillë, dhe ndoshta deri sot iniciativa më e rëndësishme e ndërmarrë nga institucionet, është inaugurimi i zyrës së Këshillit, si organ përgjegjës për koordinimin e zbatimit dhe funksionalizimit të OZHQ-ve në Kosovë.

Prapëseprapë, kur është fjala për zbatimin e prioriteteve të lidhura drejtpërsëdrejti me arritjen e Agjendës 2030, vendi duket të mbetet prapa vendeve të tjera fqinje. Prandaj, ky seksion synon të analizojë tendencat e zhvillimit në secilën prej objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të grupuara në pesë shtylla: mjedisore, ekonomike, të drejtat e njeriut, arsimi dhe shëndeti. Duke marrë parasysh numrin e kufizuar të statistikave të nxjerra nga ASK, ne i kemi bazuar analizat tona në mbledhjen e të dhënave primare dhe sekondare. Kjo është bërë ashtu që të ketë një ide të zgjeruar të informacionit, e që është i nevojshëm për të kuptuar se sa Kosova ka përparuar drejt OZHQ-ve, ku po punohet dhe ku po stagnon.

²³ Plani për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), 2016. Raporti i Zhvillimit Njerëzor i Kosovës 2016. E qasshme në: http://hdr.undp.org/sites/default/files/human_development_report_2016.pdf



5.1. Dimensioi Mjedisor

Korniza për qëndrueshmërinë mjedisore në OZHQ thekson se suksesi i qëllimeve mjedisore varet nga korniza institucionale, politike dhe llojin e qeverisjes, për të siguruar zbatimin e tyre dhe pajtueshmërinë me qëllimet e tjera²⁴. Kjo vjen si rezultat i mishërimit të dimensionit mjedisor në zhvillimin e qëndrueshëm dhe kapacitetit të institucioneve vendimmarrëse në mbrojtjen e mjedisit që na rrethon, duke ndërmarrë politika dhe veprime miqësore për mjedisin.

Çështjet mjedisore kanë qenë tash e shumë kohë pjesë e agjendës ndërkombëtare, vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Akterët global janë të vendosur në bërjen e mjedisit prioritet para se të krijohen pasoja të pakthyeshme për të ardhmen e planetit. Situata mjedisore në Kosovë, siç do të tregojë punimi tutje, është një aspekt veçanërisht sfidues dhe në të cilin vendi është duke mbetur shumë pas. Kjo po ndodh për shkak se institucionet nuk prodhojnë të dhëna të mjaftueshme për aspektet mjedisore, si dhe institucionet kyçe në çështjet mjedisore neglizhojnë përpjekje për të integruar objektivat e OZHQ-ve në strategji të fokusuara në përmirësimin e situatës mjedisore. Nëse institucionet përgjegjëse i kushtojnë vëmendjen e duhur situatës mjedisore të vendit dhe trajtojnë pengesat e lartpërmendura, vendi do të jetë në gjendje të ndërmarrë vendime të mirinformuara në lidhje me çështjet mjedisore, të krijojë politika të shëndosha dhe të promovojë arritjen e Agjendës 2030 në lidhje me dimensionin mjedisor.

Qëllimet mjedisore mbulojnë një sërë çështjesh të rëndësishme për qëndrueshmërinë mjedisore të tilla si sigurimi i shërbimeve të përballueshme dhe moderne të energjisë (OZHQ 7); krijimi i qyteteve të qëndrueshme dhe të sigurta (OZHQ 11); lufta kundër ndryshimit të klimës (OZHQ 13); shfrytëzimi efikas i oqeanëve, deteve dhe burimeve ujore (OZHQ 14); dhe ruajtja, restaurimin dhe mbrojtja e ekosistemeve, degradimi itokës dhe biodiversitetit (OZHQ 15).

²⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), 2013. Një qasje e integruar për vendosjen e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm. E qasshme në: <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/2226UNEP%20Post%202015%20Disc%20Paper%201%20Summary%20for%20decision%20makers%20Sept2013.pdf>

Energjia

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Përqindja e popullsisë me qasje në energji elektrike (%) ²⁵	98.377	0	99.43	99.774	99.943	99.943	100	100	/	/
Konsumi total i energjisë (GWh)	5,275	5,506	5,584	5,467	5,520	5,399 ²⁶	5,570 ²⁷	5,342 ²⁸	5,686 ²⁹	/
Sasia totale e konsumuar e energjisë së ripërtëritshme (%)	/	/	/	4.54	4.49	4.7	4.77	6.89	6.42	/

Në Kosovë, përqindja e popullsisë me qasje në energji elektrike ka ndjekur trende në rritje. Sipas të dhënave më të fundit të ofruara nga Banka Botërore, në vitin 2016, 100% e popullsisë ka qasje në energji elektrike. Konsumi i përgjithshëm i energjisë për vitet e fundit gjithashtu ka ndjekur trende në rritje, me pak përjashtime. Konsumi më i lartë i energjisë i shënuar ka qenë në vitin 2017 me vlerë 5.686 GWh. Vlen të theksohet se sipas raporteve vjetore të Zyrës e Rregullatorit për Energji, konsumi i paautorizuar i energjisë vazhdon të mbetet në vlerën 17.3% të kërkesës totale. Një nga arsyet që ky konsum i paautorizuar i energjisë po vazhdon të ndodhë është për shkak se energjia elektrike është kryesisht e papërbalueshme për shoqërinë. Kjo e shtyn vendin drejt vështirësive në përmbushjen e objektivave të OZHQ-së 7.

Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor kërkojnë një sektor energjetik të përballueshëm për njerëzit dhe miqësor ndaj mjedisit. Megjithatë, hulumtimi më i fundit argumenton se funksionalizimi i termocentralit të ri të Kosovës, "Kosova e Re" - si pjesë e marrëveshjes së Qeverisë së Kosovës me kompaninë amerikane ContourGlobal – do t'i rrisë çmimet e energjisë për 92%, ndërsa ekologjikisht,

²⁵ Banka Botërore, Qasja në Energji Elektrike (% e popullsisë), e qasshme në:

<https://data.worldbank.org/indicator/EG.ELC.ACCS.ZS?end=2016&locations=XK&start=1990&view=chart>

²⁶ Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2017 (fq.43). E qasshme në: http://ero-ks.org/Annual%20Report/2014/Raporti_Vjetor_2014_ZRRE.pdf

²⁷ Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2015 (fq.41). E qasshme në: http://eroks.org/2016/Raportet/Raporti_Vjetor_2015_ZRRE_shq.pdf

²⁸ Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2016 (fq.69). E qasshme në: http://eroks.org/2016/Raportet/Raporti%20vjetor%202016%20%20ZRRE_alb.pdf

²⁹ Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2017 (fq.62). E qasshme në http://eroks.org/2017/Raportet/Raporti_vjetor_2017_ZRRE.pdf

do të krijojë efekte negative pasi mbështetet tërësisht në linjit³⁰. Thënë specifikisht, termocentrali i ri do t'a bëjë Kosovën plotësisht të varur nga energjia e qymyrit për 20 vitet e ardhshme, duke penguar kështu hapjen e tregut të energjisë së ripërtëritshme në të ardhmen.

Marrë parasysh ndikimin që energjia e ripërtëritshme ka në shëndetin publik dhe në uljen e emetimeve të CO₂, për Kosovën megjithatë, këto janë vetëm pengesa tjera për krijimin e një sektori energjetik të qëndrueshëm, pasi konsumi i energjisë i vendit mbështetet jashtëzakonisht pak në burimet e ripërtëritshme të energjisë. Të dhënat e siguruar nga ASK (të dhënat e disponueshme vetëm nga 2012), tregojnë se megjithatë mbështetja në burime të tilla ka ndjekur trende në rritje, edhe pse ka mbetur vetëm në rreth 6% gjatë viteve të fundit.

Sa i përket krijimit të qyteteve të qëndrueshme dhe të sigurta, të dhënat për këta tregues mbeten kryesisht të pakta. Vetëm 1 nga 14 treguesit janë gjetur. Kjo e bën praktikisht të pamundur matjen e progresit që vendi ka shënuar në këtë drejtim. Megjithatë, në lidhje me grumbullimin e mbeturinave, shumica e mbledhur në vit ka ndjekur trende rritëse, nga 302,205 ton në vitin 2014 në 363,742.87 ton në vitin 2017.³¹

Në këtë drejtim, ky është i vetmi tregues që të dhënat janë gjetur - megjithëse nuk janë të ofruara nga ASK-ja, edhe pse duket që po ndiqet një trend pozitiv.

Për qëllimet e lidhura me luftimin e ndryshimeve klimatike (OZHQ 13) dhe mbrojtjen dhe rivendosjen e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore (OZHQ 15), nuk ka të dhëna. Po që se do të ekzistonin këto të dhëna, ato do të ndihmonin shumë në analizimin e harmonizimit midis qëllimeve dhe përpjekjeve të Kosovës në përmbushjen e tyre. Sidoqoftë, kur është fjala për mbrojtjen e biodiversitetit, aktualisht në Kosovë ekzistojnë vetëm dy zona të mbrojtura në Kosovë, për parkun kombëtar specifik të biodiversitetit "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna". Ndërsa, Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm në lidhje me oqeanet dhe detet (OZHQ 15,) nuk është i zbatueshëm për rastin e Kosovës.

³⁰ Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), 2018. Kontrata për Ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re". E qasshme në: https://indep.info/wp-content/uploads/2018/04/INDEP-Kontrata-me-Kosoven-e-Re-fin.pdf?fbclid=IwAR1_NPqVgFT0rmKAaqaCy89SEWoXsEfned46nRzahZsWxUyThaEsvKIFGc

³¹ Instituti për Politika Zhvillimore, INDEP (2018). Menaxhimi i Mbeturinave në Kosovë: Identifikimi i Sfidave në Sektor. E qasshme në: https://indep.info/wp-content/uploads/2018/07/WM_ENG.pdf



5.2. Dimensioni Ekonomik

Dimensioni më strategjik dhe më i diskutuari gjerësisht i spektrit të zhvillimit të qëndrueshëm konsiderohet qëndrueshmëria ekonomike. Nëse ky dimension është i dobët, atëherë, sistemi në tërësi është i paqëndrueshëm. Qëllimi përfundimtar i të dyja këtyre dimensioneve është ruajtja e një të ardhme premtuese për gjeneratat që do të vijnë. Aktualisht, Kosova është në fazë shumë kritike të zhvillimit ekonomik. Vendi po lufton për të luftuar papunësinë, për të krijuar mundësi në mënyrë të barabartë për të gjithë dhe për të bërë një përdorim të mirë dhe efikas të burimeve të veta.

Si dimension, mbulon disa fusha vendimtare të zhvillimit të qëndrueshëm, si varfërinë (OZHQ 1), krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike (OZHQ 8), përmirësimin e sektorëve të inovacionit dhe infrastrukturës (OZHQ 9), dhe qëndrueshmërinë e konsumit dhe prodhimit të përgjegjshëm (OZHQ 12).

Varfëria

(%)		2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Varfëria Ekstreme ³²		/	/	/	8.1	5.8	6.9	5.2
Niveli i varfërisë		34.5	29.2	29.7 ³³	22.9	17.6	21.1	17.6 ³⁴
Niveli i varërisë,	Burra	/	/	/	22.7	17.2	20.3	17.2
	Gra	/	/	/	23.1	18.0	22.0	18.0

³² Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Grupi i Bankës Botërore, 2015. Varfëria në Konsumit në Republikën e Kosovës 2012-2015. E qasshme në: <http://ask.rks-gov.net/media/3187/poverty-report-2012-2015.pdf>

³³ INDEP, 2017. Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë, Trendet, sfidat dhe mundësitë. E qasshme në: http://www.qendrore.com/indepi/wp-content/uploads/publications_en/Sustainable%20Development%20Indicators%20in%20Kosovo%5BINDEP%2C%202016%2009%2C%20Sustainable%20Development%5D.pdf

³⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) & Grupi i Bankës Botërore, 2015.

sipas gjinisë ³⁵								
-----------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--

Varfëria ekstreme përkufizohet kur njerëzit jetojnë nën 1.90 dollarë amerikanë (1.70 euro) në ditë. Megjithëse të dhënat për Kosovën nga institucionet përkatëse mungojnë, ato të publikuara për 2015, tregojnë se 5.2% e njerëzve në Kosovë jetojnë në varfëri të skajshme. Duke krahasuar dy vitet, mund të vërehet se shkalla e varfërisë ka rënë me 6.8% prej 2011 në 2012, por më pas u rrit nga 2014 në 2015 me 3.5%.

Qëllimi i zhvillimit të qëndrueshëm në këtë drejtim është çrrënjësja e varfërisë si fenomen në të gjitha dimensionet e saj. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se shkalla e varfërisë karakterizohet me ritme mjaft të ngadalësuara dhe të shpërndara në mënyrë të pabarabartë mes meshkujve dhe femrave (siç tregohet në tabelën e mësipërme), ky fakt nuk kontribuon pozitivisht në prosperitetin ekonomik të vendit. Këtu nuk duhet harruar edhe ulja e ngadaltë e shkallës së papunësisë. Për shembull, në vitin 2017 shkalla e papunësisë ishte 29.6, ndërsa u zvogëlua vetëm në 29.4% në vitin 2018. Përveç kësaj, një pengesë tjetër që dëshmon se çrrënjësja e varfërisë në Kosovë është sfiduese është se në dy vitet e fundit, skema e mbrojtjes sociale ka ndjekur një trend ngadalë në rënie. Të dhënat dëshmojnë se numri i familjeve që marrin përfitime sociale në vitin 2017 ishte 2,761. Ky numër u ul në vetëm 2,206 në vitin 2018³⁶. Më tej, kufiri mesatar i varfërisë në BE është 9.8%, ndërsa të dhënat më të fundit tregojnë se ky nivel për Kosovën është 17.6%³⁷. Rrjedhimisht, përkundër progresit të ngadaltë (shifrat ndjekin trende në rënie), niveli i varfërisë vazhdon të mbetet alarmues, 2 herë më i lartë se mesatarja e varfërisë mesatare të vendeve të BE-së.


Grafiku 1 tregon përqindjen e buxhetit të Kosovës të investuar në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Por, në të nuk ka të dhëna të mjaftueshme të bëra sipas metodologjisë së OKB-së, për të qenë në gjendje për të projektuar trende për mbrojtjen sociale.

³⁵ Ibid.

³⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), 2018. Anketa e Fuqisë Punëtore. E qasshme në: http://ask.rks-gov.net/media/4671/anketa-e-tregut-te-punes-2018.pdf?fbclid=IwAR3fTvxGPTGiO3A7A1Jts3L-8jNe5Ba617jL6n7-d8OtKYvVLDTiYkw_ek

³⁷ Projekti Borgen, 2018. 12 Fakte rreth varfërisë në Evropë. E qasshme në: <https://borgenproject.org/facts-about-poverty-in-europe/>

Grafiku 1. Përqindja e shpenzimeve totale të qeverisë në shërbime bazike (arsimi dhe shëndetësia)³⁸



Grafiku tregon se ka pasur një rënie të ndjeshme të shpenzimeve në sektorin e shëndetësisë në vitin 2015. Shifra më e ulët e shpenzimeve është dedikuar për sektorin e shëndetësisë, sektor ky që vazhdon të ketë menaxhim të brishtë dhe të paqartë. Kurse në arsim, shpenzimet kanë vazhduar me rritje të ngadaltë. Arsimi është fushë thelbësore për të mundur krijimin e një zhvillimi të qëndrueshëm në vend, meqë ka synim nisjen e përmirësimit të cilësisë së jetës dhe zhvillimin e zgjidhjeve inovative për probleme si varfëria. Të gjitha këto tre aspekte janë të integruara mirë në OZHQ dhe konsiderohen si bazë për të siguruar krijimin dhe zbatimin e programeve dhe politikave që kontribuojnë në çrrënjosjen e varfërisë në të gjitha format e saj. Megjithatë, nëse vendi vazhdon të neglizhojë rëndësinë e ndarjes së fondeve adekuate për sektorë të tillë, ai minon mundësinë e vendosjes së Kosovës në pozitë udhëheqëse në rajon për zbatimin e Agjendës 2030, kur të vijë koha për të raportuar tek agjencitë ndërkombëtare, si OKB.

³⁸ Instituti GAP, 2018. Si i shpenzon shteti paratë tona? E qasshën në: <https://www.institutigap.org/spendings/?buxheti-i-kosoves---planifikimet/2018>

Zhvillimi Ekonomik

		2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
GDP (€ millions)		4,814.5	5,058.8 ³⁹	⁴⁰ 5,326.7	5,567.5	5,807.0	6,070.1	6,070.1	6,528.0
Rritja reale e GDP-së (%) ⁴¹		4.4	2.8	3.4	1.2	4.1	3.4	/	/
Shkalla e papunësisë (%)		/	30.9 ⁴²	30.0	35.3	32.9	28.0 ⁴³	30.6 ⁴⁴	29.4 ⁴⁵
Shkalla e papunësisë, sipas gjinisë (%) ⁴⁶	Gra	/	/	/	41.6	36.6	37.8	33.4	30.6
	Burra	/	/	/	33.1	31.8	26.2	28.5	29.1

Siç mund të shihet, GDP-ja e vendit është rritur përgjatë viteve nga 4,402 milionë euro në 2010 në 6,070.1 milion euro në vitin 2018. Megjithatë, rritja reale e GDP-së ka pësuar rënie, duke u kthyer pothuajse në të njëjtin nivel fillestar, si 3.3% në 2010. Edhe pse në vitin 2015, GDP-ja arriti kulmin me rritje prej 4.1%, ajo është ende e pamjaftueshme për nivelin e duhur të progresit ekonomik në vend. Që vendi të gëzojë një ecure të qëndrueshme ekonomike, GDP-ja duhet të rritet prej rreth 7%⁴⁷. Nga ana tjetër, papunësia sigurisht që është një tregues i mirë për të parë dinamikën e ecurisë ekonomike të vendit. Kosova ka një nga shkallat më të larta të papunësisë në rajon, duke arritur në 35.2% në vitin 2014. Shkalla e papunësisë së grave vazhdon të jetë shumë e lartë. Sipas Agjencisë së

³⁹ INDEP, 2017. Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë. Trendet, sfidat dhe mundësitë.

⁴⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018. E qasshme në: <http://ask.rks-gov.net/media/4684/bpv-tm4-2018.pdf> (përfshirë vitet 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018)

⁴¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. E qasshme në: http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata_Country%20and%20regional%20data/tec00115.px/table/tableViewLayout/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/

⁴² Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2016. Anketa e Fuqisë Punëtore. Përfshirë vitet 2012, 2013, 2014, 2015. E qasshme në: <http://ask.rks-gov.net/media/1684/rezultatet-e-anketes-se-fuqise-punetore-2015-ne-kosove.pdf>

⁴³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2016. Anketa e Fuqisë Punëtore. E qasshme në: <http://ask.rks-gov.net/media/3229/afp-2016.pdf>

⁴⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2017. Anketa e Fuqisë Punëtore. E qasshme në: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/addnews/anketa-e-fuqise-punetore-afp-tm4-2017> Raporti Vjetor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës 2017

Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018. Anketa e Fuqisë Punëtore. E qasshme në: http://ask.rks-gov.net/media/4671/anketa-e-tregut-te-punes-2018.pdf?fbclid=IwAR3fTVxGPtGiO3A7A1Jts3L-8jNe5Ba617jL6n7-d8OtKYvVLDTiYkw_elk

⁴⁶ Ibid.

⁴⁷ INDEP, 2017. Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë. Trendet, sfidat dhe mundësitë.

Statistikave të Kosovës, ndonëse statusi i punësimit të grave është përmirësuar gjatë viteve, papunësia e tyre ende mbetet më e lartë se e burrave. Statistikat tregojnë se respektivisht, 30.6% gra dhe 29.1% burra janë të papunë në Kosovë. Sa i përket normës së NEET për të rinjtë⁴⁸ e Kosovës, në vitin 2015, përqindja e tyre që nuk ishin të përfshirë në arsim, punësim apo ndonjë trajnim ishte 31.4%⁴⁹. Të dhënat më të fundit tregojnë se situata nuk është hiç më e mirë. Nuk ka pasur rënie të konsiderueshme të shifrave, duke mbetur ende në 30.1%. Përkundër që trendet e GDP-së vazhdojnë të rriten dhe, në disa mënyra kjo tregon mundësi për zhvillimin e ardhshëm ekonomik, vendi duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme adekuate për të adresuar treguesit më urgjentë ekonomikë që shfaqin regres, si papunësia te të rinjtë dhe te gratë.

Një pjesë tjetër e OZHQ-ve që shikojnë nëse strategjitë kombëtare trajtojnë punësimin e të rinjve ose nëse vendi ka krijuar strategji të veçanta për çështjen janë treguesit⁵⁰. Në fakt, institucionet duket se kanë ndërmarrë iniciativa të tilla, pasi kemi gjetur se të pesë strategjitë që trajtojnë mirëqenien sociale, arsimin dhe çështjet ekonomike, përfshihet edhe papunësia e të rinjve. Kjo shtyn në përfundimin se strategjitë e tilla mund të pritet të tregojnë efektet e tyre në të ardhmen afatgjatë, pasi aktualisht të dhënat sygjerojnë se dokumentet e planifikimit kombëtar kanë pasur pak ose aspak ndikim të dukshëm në përmirësimin e situatës së punësimit të të rinjve.

Për dy objektiva tjera të zhvillimit të qëndrueshëm; përmirësimi i sektorëve të inovacionit dhe infrastrukturës (OZHQ 9), dhe qëndrueshmëria e konsumit dhe prodhimit të përgjegjshëm (OZHQ 12), ka të dhëna tejet të kufizuara, që në këtë fazë janë të pamjaftueshme për të analizuar trendet.

⁴⁸ Kjo i referohet përqindjes së të rinjve (të moshës 15-24 vjeçare) që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim ose trajnim (e njohur edhe si "norma e NEET e të rinjve").

⁴⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018.

⁵⁰ Shtojcën: OZHQ8, Qëllimi 8.b, treguesi 8.b.1.



5.3. Të drejtat e njeriut

Krahas një game të gjerë të qëllimeve mjedisore, sociale dhe ekonomike, Agjenda 2030 mësyon edhe drejt një bote që ka *"shoqëri më paqësore, të drejta dhe gjithëpërfshirëse, të cilat janë të lira nga frika dhe dhuna"*⁵¹. Parimet e të drejtave të njeriut janë të integruara thellë në agjendë dhe zbatimin varet drejtpërdrejt nga angazhimi politik dhe mekanizmat efektiv shtetëror për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut, si dhe institucionet e vendeve për të monitoruar përparimin e këtyre të drejtave.

Kohët e fundit, Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën i konsideronte mekanizmat ekzistues përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut si joefektiv⁵². Ky konstatim pasqyrohet pa dyshim edhe në të dhënat për treguesit e OZHQ-ve që lidhen me të drejtat e njeriut. Zbatimimi i të drejtave të njeriut në Kosovë mbetet sfidues për institucionet vendore, pavarësisht faktit se e kanë të instaluar të gjithë kuadrin e nevojshëm ligjor në përputhje me standardet më të larta të BE-së.

Të drejtat e njeriut, si dimension, janë në një ose tjetrën mënyrë të ndërlidhur me të gjitha objektivat dhe qëllimet e OZHQ-ve, qoftë të aspekteve ekonomike, arsimore apo shëndetësore. Megjithatë, me qëllim të trajtimit të secilës dimension veçmas, aspektet e të drejtave të njeriut më poshtë do të mbulojnë OZHQ-të që lidhen vetëm drejtpërdrejt me dimensionin. Për këtë arsye, do të trajtohen barazia gjinore (OZHQ 5), pabarazitë e reduktuara (OZHQ 10) dhe paqja, drejtësia dhe institucionet e forta (OZHQ 16).

⁵¹ Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR). Të Drejtat e Njeriut dhe Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. E qasshme në: <https://www.ohchr.org/en/issues/SDGS/pages/the2030agenda.aspx>

⁵² Komisioni Evropian, 2019. Raporti i Kosovës për vitin 2019. E qasshme në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

Barazia Gjinore

		2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gratë e sulmuara seksualisht		/	/	17	12	7 ⁵³	/
Përqindja e ulëseve të mbajtura nga gratë në parlament (%)		43.6	43.6	43.6	44.2 ⁵⁴	44.4	44.4 ⁵⁵
Përfaqësimi i grave në nivel komunal (%)	Gra	5625	25	28	/	5733.0	33.4
	Burra	75	75	72	/	66.8	66.5
Përfaqësimi i grave në qeveri (%) ⁵⁸	Gra	39.6	38.8	41.0	40.6	40.5	41.6
	Burra	60.4	61.2	58.2	59.4	59.4	58.0

Në përgjithësi, ekziston një mungesë e madhe e të dhënave në lidhje me dhunën në bazë gjinore dhe përfaqësimin gjinor në institucione. Rreth këtij problemi, arritëm të grumbullonim të dhëna të siguruara kryesisht nga burime të besueshme dytësore ose të dhëna të mbledhura me anë të pyetësorëve. Qëllimi i zhvillimit të qëndrueshëm që kërkon krijimin e një konteksti mjedisor ligjor dhe praktik në vend, e që do të siguronte barazinë gjinore pastaj, paraqet një sërë treguesish të rëndësishëm rreth objektivit. Megjithatë, në këtë punim konstatohet se ekzistojnë të dhëna të disponueshme për një numër jashtëzakonisht të ulët të treguesve, saktësisht për vetëm tre nga katërmbëdhjetë treguesit, sa janë gjithsej.

Tabela e mësipërme tregon se ka pasur një trend pozitiv në rritjen e përfaqësimit të grave në parlament, trend ky që kontribuon në drejtim të qëllimeve të OZHQ 5. Pavarësisht kësaj rritjeve, përfaqësimi gjinor mbetet i kufizuar në nivelin komunal dhe atë qeveritar, duke mos e marrë parasysh kërkesën ligjore për përfaqësim të barabartë në të dyja nivelet (50:50)⁵⁹. Në komunat e Kosovës, gratë

⁵³ Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), 2018. Qasja në Drejtësi e Viktimave të Dhunës me Bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i Mosndëshkimit të Autorëve të Krimit. E qasshme në: http://www.kipred.org/repository/docs/Qasja_n%C3%AB_drejt%C3%ABsi_e_viktimave_t%C3%AB_dhun%C3%ABs_me_baz%C3%AB_gjinore_n%C3%AB_Kosov%C3%AB_P%C3%ABfundimi_i_mosnd%C3%ABshkimit_t%C3%AB_autor%C3%AB_528871.pdf

⁵⁴ Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2017. Pjesëmarrja e Grave në Vendimmarrje në Kosovë. E qasshme në: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/womens_participation_en.pdf

⁵⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Lista e Deputetëve për Mandatin 2017-2021. E qasshme në: <http://deputetet.kuvendikosoves.org/Deputies/DeputiesList?languageid=1>

⁵⁶ Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2017.

⁵⁷ INDEP, 2019. Gratë në Vendimmarrje në Institucionet Publike në Kosovë. E qasshme në: https://indep.info/wp-content/uploads/2019/03/INDEP_Women-in-decision-making-in-public-institutions-in-Kosovo-1.pdf?fbclid=IwAR2G0176mLOX6K3PtOdLjDtf3d_HNp5qP_xKkJS45jFeEazun6uXASpSUg

⁵⁸ Ibid.

⁵⁹ Shih Ligjin Nr. 05 / L-020 për Barazinë Gjinore, veçanërisht nenin 6 që thekson se "përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislativë, ekzekutive, gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet një përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50% gjinore, përfshirë edhe organet e tyre qeverisëse dhe vendimmarrëse".

përfaqësohen vetëm me 33.4%, krahasuar me burrat që përfaqësohen dukshëm më shumë me 66.5%. Ndërsa, në qeverinë aktuale gratë përfaqësohen me 41.6%. Nga kjo del se ligji nuk po zbatohet plotësisht, pasi një barazi e tillë gjinore joproporcionale mbetet problem që kërkon masa të duhura të ndërhyrjes institucionale.

Kur diskutohet për dhunën në baza gjinore, megjithëse korniza ligjore mbulon disa akte të kësaj, vazhdon të mungojë një përkufizim gjithëpërfshirës i dhunës në baza gjinore në përputhje me procedurat penale dhe civile të saj⁶⁰. Kjo duket se po ndikon edhe në efektivitetin e institucioneve në ndjekjen penale dhe dënimin e akteve të dhunës në bazë gjinore. Ky faktor lidhet me OZHQ16, që kërkon nga vendet të krijojnë institucioneve të forta. Rrjedhimisht, edhe në këtë aspekt, kjo e lë vendin prapa. Vendi po stagnon në garantimin e sigurisë për shoqërinë e tij, i cili në të njëjtën kohë minon edhe efektivitetin institucional.

⁶⁰ KIPRED 2018.

Korrupsioni

		2016	2017	2018
Numri i rasteve të korrupsionit në 12 muajt e fundit	Numri i njerëzve	/	/	1389
	Numri i rasteve	/	/	638
Indeksi i perceptimit të korrupsionit (në 100)		36	39 ⁶¹	/
Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e institucioneve publike (%)		/	36	36

Përveç efektivitetit institucional, element tjetër që ka kontribuar bukur shumë në minimin e punës së institucioneve të vendit është korrupsioni. Treguesi 16.5.1 i OZHQ 16 kërkon të dhëna për rastet e korrupsionit vetëm në 12 muajt e fundit. Numri i këtij treguesi në Kosovë për një periudhë të tillë është 638. Në përgjithësi, korrupsioni si fenomen është thellë i rrënjësuar në institucionet vendimmarrëse të vendit⁶². Ndonëse numri ndryshon dhe të dhënat për këtë dukuri vazhdojnë të mbeten të pakta, hulumtimet më të fundit tregojnë se korrupsioni, papunësia dhe varfëria janë tri çështjet që i shqetësojnë më së shumti qytetarët. Kjo vjen si rezultat i performancës së dobët institucionale. Kjo u evidentua tutje edhe kur vetëm 36% e qytetarëve pohuan të jenë të kënaqur me punën e institucioneve kyçe (shifra nuk ka pasur ndonjë rritje të konsiderueshme gjatë viteve)⁶³. Qytetarët gjithashtu shtuan se korrupsioni i shkallës së lartë është element konstant i funksionimit të institucioneve publike.

Shumica e kosovarëve (68.8%) mendojnë se faktorët e llojit jomeritorë (ryshfeti, aleancat partiake, miqtë, dhe dukshëm edhe lidhjet familjare) janë faktorë vendimtarë për punësim në institucionet publike⁶⁴. Kjo paraqet sfidë tjetër për Kosovën, drejt arritjes së objektivave që kërkojnë krijimin e institucioneve të forta. Kjo e drejtë themelore e qytetarëve për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë dhe të drejtë nuk po zbatohet.

⁶¹ Transparency International, 2019. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2017. E qasshme në: https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2017

⁶² Instituti i Kosovës për Drejtësi, 2019. Pandëshkueshmëria e Korrupsionit Rrezik për Shoqërinë dhe Shtetin. E qasshme në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/03/1.-Tri-vjet-kunder-korrupsionit-IKD-versioni-SHQIP.pdf?fbclid=IwAR1Tt2I6KIgLxAwzZ5Bhc49HhH5aXBwgrK0dH4OXhIWZ4iZryD8LMaTgmUA>

⁶³ Plani i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë, 2019. Pulsi Publik XV. E qasshme në: http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-xv.html

⁶⁴ Ibid.

5.4. Edukimi



Arsimi është një aspekt tjetër me rëndësi në matjen e prosperitetit të një shoqërie. Në Kosovë, ky është veç një tjetër sektor që po has në sfida dhe vështirësi të shumta. Sektori si i tillë, është privuar nga investime të mëdha, qenësore për të përmirësuar cilësinë dhe infrastrukturën e tij.

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm i përqendruar në arsim, kërkon që deri në 2030, vendet e zotuara të zbatojnë agjendën dhe të kenë krijuar arsimim cilësor. Deri në vitin 2030, agjenda kërkon nga vendet të sigurohen që rinia e tyre të jetë e pajisur me aftësi funksionale për shkrim, lexim dhe numërim, dhe poashtu, të rrisë numrin e fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor. Gjithashtu, kërkohet nga këto vende që të sigurojnë qasje të barabartë për të gjitha gratë dhe burrat në arsimim të përballeshëm dhe cilësor, trajnim profesional dhe universitet. Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm i grupuar në këtë kategori renditet si OZHQ 4, e që merret kryesisht me arsimin cilësor.

Edukimi kualitativ

Niveli i arsimit	2015/16		2016/17	2017/18	2018/19
	Numri i fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor	4.792 ⁶⁵	3.809 ⁶⁶	4.286 ⁶⁷	8.335 ⁶⁸
Fillor dhe i mesëm i ulët	283.239	269.981	266.722	263.686	
I mesëm i lartë	86.376	86.447	88.444	84.249	

⁶⁵ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2016. E qasshme në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/01/shenime-statistikore-2015-16-arsimi-parauniversitar.pdf>

⁶⁶ ASK, 2017. <http://ask.rks-gov.net/media/3439/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB-shqip.pdf>


⁶⁷ ASK, 2018. <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>

⁶⁸ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2019. E qasshme në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/02/shenime-statistikore-2018-19-arsimi-parauniversitar.pdf>

Shkalla e shkrimit-leximit të rriturit (%) ⁶⁹	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
	69.90	70.15	70.50	70.80	71.10	71.35	71.65	/	/
Investimet në arsim (% e GDP-së) ⁷⁰	/	4.03	4.60	4.38	4.4	4.5	/	/	/

Numri i fëmijëve që ndjekin edukimin parashkollor është vendimtar në përmirësimin e zhvillimit fizik, social, intelektual dhe emocional të fëmijëve. Në këtë aspekt, në Kosovë, të dhënat e siguruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, tregojnë se ka trend pozitiv në rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin parashkollor. Përdërisa numri i këtyre nxënësve në vitin shkollor 2017/18 ishte 4,286, kjo shifër u dyfishua në atë 2018/19, duke arritur kështu në 8,335.

Grafi 2. Proporcioni i studentëve që ndjekin universitetin



Tek ndjekja e arsimit të lartë, numri është rritur përgjatë viteve. Megjithëse përgjithësisht perceptohet si trend pozitiv, rrethanat aktuale të zhvillimit të vendit parandalojnë një përkufizim të tillë. Shembull, të dhënat tregojnë se numri i studentëve të regjistruar është rritur për gjashtëfish, me 21,564 studentë

⁶⁹ INDEP, 2018. Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë. E qasshme në: <https://indep.info/wp-content/uploads/2019/07/Sustainable-Development-Indicators.pdf?fbclid=IwAR2F0WliveRwcU4FjRQIX925yQ7bj7cZ7EYdBa1AbbYBhJKgijcpuWR3SBk>

⁷⁰ Ibid.

sa ishin në vitin 2008, numri arriti në 120,429 në vitin 2015⁷¹. Indikatorë të tillë përdoren shpesh nga retorika e institucioneve përkatëse qeveritare për të ulur shkallën e lartë të papunësisë, në vend se të rrisin cilësinë e përgjithshme të arsimit, e në veçanti aftësitë e fituara nga studentët prej universiteteve⁷². Në vitin 2017, numri ka përjetuar rënie të vogël siç shihet në grafikën e mësipërme, ndërsa të dhënat për 2018 dhe 2019 nuk janë bërë ende të disponueshme.

Sa i përket buxhetit për sektorin e arsimit si përqindje e GDP-së, tash për tash ekzistojnë të dhëna jo të plota. Megjithatë, hulumtimet e kaluara tregojnë se investimi shtetëror në arsim është zvogëluar me gati 50% në vitin 2015, krahasuar me vitin 2008, që ishte 8.20%⁷³. Nëse investimet vazhdojnë të ndjekin trendin e njëjtë, domethënë pa rritje të konsiderueshme, atëherë duke pasur parasysh mbipopullimin e universiteteve, kjo mund të ndikojë negativisht në nivelin e cilësisë së arsimit që u ofrohet studentëve.

⁷¹ INDP, 2017. Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë. Trendet, sfidat dhe mundësitë.

⁷² Ibid.

⁷³ Ibid.



5.5. Shëndetësia

OKB i sheh objektivat lidhur me shëndetësinë si të domosdoshme për zhvillim të qëndrueshëm. Përpijekjet numerike janë të paevitueshme për të çrrënjësuar plotësisht sëmundjet e vargëshme dhe për të trajtuar shumë çështje të ndryshme të vazhdueshme dhe në probleme të reja shëndetësore që po shfaqen kohëve të fundit. Organizata bën thirrje për përqëndrimin e fondeve efikase në sistemet shëndetësore, në përmirësimin e kanalizimeve dhe higjenës, në rritjen e qasjes së mjekëve dhe në zvogëlimin e ndotjes së ambientit.

Seksioni i Shëndetit në kuadër të OZHQ-ve është i lidhur edhe me seksionet mjedisore, ekonomike dhe të të drejtave të njeriut. Mirëpo pavarësisht lidhjes, ky seksion kryesisht mbulon qëllimet që trajtojnë drejtpërsëdrejti shëndetin dhe mirëqenien, siç është uria (OZHQ 2), krijimi i objekteve që garantojnë shëndet dhe mirëqenie (OZHQ 3) dhe qasje në ujë të pastër e kanalizime (OZHQ 6).

Sa i përket disponueshmërisë së të dhënave për sektorin e shëndetësisë në Kosovë, ekziston një mungesë e madhe e të dhënave që ofrohen nga institucionet zyrtare. Kjo minon procesin e prioritizimit të nënsektorëve brenda sistemit shëndetësor që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente, si dhe e bën pothuajse të pamundur vlerësimin e progresit që vendi ka arritur në drejtim të përmbushjes së objektivave të qëllimeve të lartpërmendura. Në përgjithësi, zakonisht dakordohet se sektori i tillë mbetet sektori më i brishtë dhe më keq i menaxhuar në vend. Kjo është rezultat i krijuar nga investime të pakta dhe reforma të dobëta në nënndarjet shëndetësore.

Shkalla e vdekshërisë

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Shkalla e vdekshmërisë të të porsalindurit (në 1,000)	12	12	12	12	12 ⁷⁴	11.4 ⁷⁵	/	/	/
Shkalla e vdekshmërisë së nënave në 100,000 të porsalindur	/	3.7 %	3.7 %	3.7 %	3.7%	3.7% ⁷⁶	/	/	/
Niveli i vdekshmërisë të fëmijet nën pesë vjeç (në 1,000)	34	62	25	41	24	23 ⁷⁷	/	/	/

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura, vdekshmëria të të porsalindurit qëndron e menaxhueshme. Numri i foshnjave që vdesin para se të arrijnë moshën 1 vjeçare në 1,000 lindje, nuk ka pasur rritje në të dhënat në dispozicion për periudhën katërvjeçare (2010-2014). Më vonë, në 2015 ka një rënie të lehtë në numër. Mungesa e të dhënave e bën të pamundur vlerësimin dhe krahasimin e normës së vdekshmërisë të foshnjët në vendin tonë me normat e vendeve të tjera. Megjithatë, me këto shifra, Kosova ka vdekshmërinë më të lartë të foshnjeve në rajon⁷⁸. Niveli i shëndetit i grupeve tjera është në gjendje më të mirë. Niveli i vdekshmërisë nën 5 vjeç i referohet probabilitetit të vdekjes para moshës 5 vjeçare, në 1,000 lindje. Shifrat tregojnë se nuk ka pasur rritje të numrit.

Nga ana tjetër, vdekshmëria të nënat, e cila në katër vitet e fundit ka qenë e palëvizshme me 3.7 në 100,000, është më e ulët se në disa vende tjera fqinje. Megjithatë, këto të dhëna duhet të merren me kujdes të shtuar, pasi të dhënat e Sistemit të Informacionit Shëndetësor mbeten të pakta. Supozohet se këto të dhëna janë më të larta për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian⁷⁹. Agjenda 2030 bën thirrje që deri në vitin 2030 të gjithë njerëzit, në veçanti njerëzit në situata të cënueshme, të varfërit dhe

⁷⁴ UNICEF Kosova, 2017. Analiza e Situatës së Fëmijëve dhe Grave në Kosovë (RKSKB 1244). E qasshme në: https://www.unicef.org/kosovoprogramme/Raporti_unicef_anglisht_web.pdf

⁷⁵ INED, 2015. Lindjet, vdekjet dhe vdekshmëria të foshnjët. E qasshme në: https://www.ined.fr/en/everything_about_population/data/europe-developed-countries/birth-death-infant-mortality/

⁷⁶ Ibid.


⁷⁷ INDEP, 2017. Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë. Trendet, sfidat dhe mundësitë.

⁷⁸ Shkalla mesatare e vdekshmërisë të foshnjët për vendet e BE është 3.5, ndërsa për vendet e tjera evropiane (me përjashtim të Kosovës) është 4.8. Shih: https://www.ined.fr/en/everything_about_population/data/europe-developed-countries/birth-death-infant-mortality/

⁷⁹ UNICEF, 2017.

foshnjët, të kenë qasje në ushqim me vlera ushqyese dhe të mjaftueshëm gjatë gjithë vitit (Qëllimi 2.1). Përkundër faktit se ka mungesë jashtëzakonisht të madhe të të dhënave që do të ndihmonin në vlerësimin e qëllimeve të OZHQ 2. Agjencia e OKB-së që vepron në Kosovë, UNICEF, lidhur me këtë çështje raporton se 1 në 3 fëmijë nën moshën 5 vjeç, vuajnë nga mungesa e vitaminës A dhe se më pak se 2 në çdo 10 fëmijë nën moshën 5 vjeç, vuajnë nga rritja e ngadalshme. Në këto raportime vlerësohet se 5% e fëmijëve në vend janë të kequshqyer dhe 1 në çdo 10 fëmijë nën moshën 5 vjeç, vuan nga kequshqyerja e përhershme⁸⁰. Kjo pasqyron paaftësinë e vendit për të menaxhuar çështjet e lidhura me sektorin shëndetësor, duke vënë në rrezik tejet të madh perspektivën e saj drejt përmbushjes së Agjendës 2030.

Grafi 3. Siguria në trafikun rrugor



Aspekt tjetër që bie në kundërshtim me kërkesën e Agjendës 2030 është që vendet të përgjysojnë numrin e fataliteteve dhe lëndimeve nga aksidentet në trafikun rrugor deri në vitin 2020. Sipas statistikave të marra nga Policia e Kosovës, numri i aksidenteve me fatalitet dhe lëndimet kryesisht po ndjekin trende në rritje⁸¹. Kjo e pengon sigurinë publike, në të cilën pastaj kërkohen ndërhyrje urgjente institucionale. Që prej rritjes së theksuar që ndodhi në vitin 2016, numri i aksidenteve ka rënë. Kjo nuk ka ndodhur edhe me numrin e viktimave. Ky numër është duke përjetuar vetëm rënie të lehtë. Që edhe ky numër të ndjekë të njëjtin trend, vendi duhet të përpiqet shumë. Marrë parasysh se është

⁸⁰ UNICEF Kosovë, 2019. Vitet e hershme. E qasshme në: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/children.html>

⁸¹ Raportet Vjetore të Policisë së Kosovës. E qasshme në: http://www.kosovopolicia.com/repository/docs/Raporti_vjetor_i_pun%C3%ABs_s%C3%AB_Policis%C3%AB_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2015_-_SHQIP.pdf (2015); http://www.kosovopolicia.com/repository/docs/RAPORTI_ANG LISHT_2017.pdf (2017); http://www.kosovopolicia.com/repository/docs/RAPORTI_VJETOR_ANG LISHT.pdf (2018)

vetëm kohë dyvjeçare për të arritur qëllimin prej tash, vendi duhet të luftojë në këtë drejtim për të përmbushur qëllimin e caktuar për vitin 2020.

Uji i pijshëm

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Proporcioni i popullsisë me qasje në ujë të pijshëm dhe të sigurtë (Njësia Mil M3) ⁸²	/	/	56.08	52.68	53.9	53.75	55.84	59.74	62.07	/	/

Qasja në ujë të pijshëm dhe të sigurtë është shndërruar në problem të madh që ndikon në çdo rajon. Është veçanërisht aspekt sfidues dhe vështirë i zgjidhshëm për vendet, sidomos për ato në zhvillim e sipër. OKB-ja raporton se mungesa e ujit i ka prekur më shumë se 40% të njerëzve në mbarë globin. Kjo është shifër alarmante që pritet të rritet edhe më tutje në vazhden e rritjes së temperaturave globale, e që është pasojë e ndryshimeve klimatike.

Garantimi i qasjes në ujë të sigurtë dhe me çmim të përballueshëm deri në vitin 2030, thërret për investime në infrastrukturë adekuate, ngritje të objekteve sanitare dhe sigurim higjienë në çdo nivel. Në Kosovë kjo qasje është rritur përgjatë viteve, nga 56.08% në vitin 2010 në 62.06% në vitin 2016. Pavarësisht rritjes, disponueshmëria e kufizuar e të dhënave e bën të pamundur shqyrtimin e aspekteve tjera vendimtare që prekin shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë që përdor shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurtë dhe sa ujëra të zeza të trajtuara në mënyrë adekuate. Krahas kësaj, konsiderohet se infrastruktura e dobët e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve, privon shumë qytetarë nga qasja e sigurtë në ujë të pijshëm. Si shkak i këtij problemi, zgjidhja përfshin ndarje të fondeve dhe pajisjeve adekuate për menaxhim të problemit.

⁸² ASK, 2017. Statistikat për Ujë në Kosovë. E qasshme në: <http://ask.rks-gov.net/media/3980/statistikat-e-uj%C3%ABrave-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2016-2017.pdf>

6. Përfundimi

Kosova ka ndërmarrë disa hapa pozitiv drejt agjendës për zhvillimit të qëndrueshëm, sidomos me krijimin e Këshillit që merret me implementimin e OZHQ-ve dhe nxjerrjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. Megjithatë, veprimet konkrete kanë qenë të kufizuara dhe shpesh kanë mbetur veç në retorikën politike. Vendi ka arritur gjithashtu progres të konsiderueshëm në aspektin ekonomik, dhe në një farë mase, edhe në dimensionin mjedisor, por kur bëhet fjalë për fusha të tjera që gjithashtu janë substanciale për zhvillim si, shëndetësia, arsimi, drejtësia dhe krijimi i institucioneve të forta, vendi po stagnon dhe po has në vështirësi. Njëkohësisht, ekziston një mungesë tejet e dukshme e monitorimit të zbatimit të legjislacionit. Po të ekzistonte ky monitorim, do të shërbente si vlerë matëse e politikave, si dhe do të rriste ndërgjegjësimin rreth politikave dhe aktiviteteve që i parasheh Agjenda 2030.

Rëndësia e Agjendës 2030 për zhvillimin e ardhshëm të vendit dhe për perspektivën e saj në anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe në BE, është e lartë. Pavarësisht këtij fakti, lënja pas dore në përfshirjen e agjendës në dokumentin kyç politik, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, pamundëson gjasat e vendit për t'u paraqitur si entitet i aftë për të kryer detyra të klasit ndërkombëtar.

Vlerësimi i ecurisë së punës drejt përmbushjes së Agjendës 2030 për vendin është dëshmuar të jetë proces sfidues, duke konsideruar faktin se disponueshmëria dhe qëndrueshmëria e të dhënave është e vogël. Edhe pse të dhënat e vëna në dispozicion nga Agjencinë e Statistikave të Kosovës duket se janë përmirësuar gradualisht, ato mbeten të pamjaftueshme dhe ndonjëherë nuk janë as relevante për të marrë informacionin e nevojshëm rreth treguesve të OZHQ-ve. Treguesit e kornizës globale të OZHQ-ve konsiderohet gjerësisht si strukturë e përgjithshme e treguesve që çdo vend i merr parasysh varësisht nga konteksti i atij vendi. Rjedhimisht, për Kosovën si shembull, indikatorët e OZHQ 14 (që lidhen me detet dhe oqeanet) nuk janë të zbatueshme pasi që vendi nuk ka qasje në det. Megjithatë, për treguesit e tjerë që janë të rëndësishëm dhe normalisht janë prej treguesve kryesorë që duhet të garantohen prej shumicës së vendeve, në Kosovë të dhënat e tyre janë jashtëzakonisht të vogla dhe jo të plota. Midis këtyre treguesve janë: përqindja e popullsisë që jeton në familje me shërbime bazë; flukset totale zyrtare në sektorin e bujqësisë dhe të dhëna konkrete për abuzimin fizik, kujdesin shëndetësor seksual dhe atë riprodhues. Sigurimi i të dhënave për treguesit e objektivave të OZHQ-ve nuk janë vetëm mjete të dobishme për institucionet e Kosovës për të kuptuar se në çfarë faze të zhvillimit qëndron vendi, por ato mund të shërbejnë si informacione të vlefshme preventive dhe si ndihmë në marrjen e vendimeve mirë të informuara.

Problemet dhe çështjet që Agjenda 2030 i ka përcaktuar kanë rëndësi të madhe për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm të të gjitha vendeve, prandaj vendet e zotuara për zbatimin e kësaj agjende kanë mjaftëpunë për të bërë në përsheptimin e veprimeve për përmbushjen e agjendës. Njësi të shumta tashmë veçse kanë filluar, ndërsa Kosova mund të ndjekë shembullin e vendeve fqinjëve, si Shqipëria dhe Mali i Zi, të cilët po udhëheqin në rajon në përpjekjet për zbatimin e OZHQ-ve. Kjo bëhet nëse retorika politike lihet mënjanë, dhe nisnin praktikën në zbatimin e agjendës. Procesi drejt zbatimit të

OZHQ-ve është sfidues, por në shumë aspekte paraqet një përvojë fitimprurëse për shoqërinë kosovare.

7. Rekomandimet

1. Gjatë kryerjes së hulumtimit tonë, kemi hasur në disa sfida në grumbullimin e të dhënave. Për këtë arsye, ne i rekomandojmë specifikisht Agjencisë së Statistikave të Kosovës, që:
 - a. Të përpilojë një listë të treguesve globalë që janë të zbatueshëm në kontekstin e Kosovës dhe të sugjerojë tregues sipas metodës që udhëzon OKB-ja;
 - b. Të rishikojë setin e publikimeve dhe të sigurohet që boshllëqet e lëna në statistika të plotësohen me të dhëna - të dhëna që gjithashtu përputhen me të dhënat tjera të ofruara nga institucionet e tjera zyrtare; dhe
 - c. Të sigurohet që të dhënat tremujore të ofrohen për të gjithë sektorët dhe që të gjithë sektorët të mbulojnë treguesit globalë, e jo vetëm një numër të kufizuar sosh.
2. Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm i Kosovës të monitorojë Ligjin për Statistikat Zyrtare (Ligji Nr. 04/L-036), specifikisht në lidhje me të dhënat dhe të kërkojë përgjegjësi nga agjencia kur këto të dhëna nuk vihen në dispozicion.
3. Institucionet e Kosovës të fillojnë të ndërmarrin veprime rreth Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm që ngërthejnë edhe përshpejtimin e integritet evropian dhe t'a dinë se duke punuar në zhvillim dhe integrim, këto reciprokisht e përforcojnë njëra-tjetrën. Ide se si mund t'a bëjnë këtë është duke publikuar dokumente politikash që shfaqin rëndësinë e raportit të Agjendës 2030 dhe pranimin në BE në kontekstin kosovar; pikërisht kjo duhet të jetë prioritet për vendin. Ky veprim do t'a shtynte vendin përpara në të dyja agjendat njëkohësisht dhe, gjithashtu, do t'i definonte qartë edhe pengesat e hasura rrugës.
4. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të ndërmarrë iniciativë për përfshirjen e koncepteve të qëndrueshme në planprogramet e shkollave të mesme, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimin për OZHQ-të. Në këtë mënyrë, do t'i njoftonin nxënësit për së afërmi me konceptet që kanë të bëjnë me spektrin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe do t'i inkurajonin ata të kuptojnë se si e konsideron arsimin cilësor agjenda globale.
5. Në vend se të fillojnë nga zeroja ose të përsërisin punën dhe strategjitë që janë ndërmarrë tashmë, detyra e menjëhershme e Qeverisë do të ishte krijimi i një mekanizmi zyrtar në Zyrën e Kryeministrit. Ky organ të koordinojë komunikimin ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile, si kontribuim për zbatimin e Agjendës 2030.
6. Të forcohen marrëdhëniet e institucioneve tona me organizatat ndërkombëtare të përfshira në zhvillimin e qëndrueshëm, programet dhe strategjitë e drejtuara drejtpërdrejtë kah prioritetet e Agjendës 2030 për Kosovën.
7. Qeveria, në bashkëpunim me Këshillin për OZHQ, të sigurojë operacionalizimin e Agjendës 2030 në nivel lokal. Kjo do të zgjidhte vendosjen e pikave qendrore të OZHQ-ve në secilën komunë. Në rast se aspektet më të neglizhuara që janë pengesë në përmbushjen e objektivave të Agjendës 2030 trajtohen, asnjë grup i shoqërisë kosovare nuk do të lihej pas dore.

